



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE
KRIMIN E ORGANIZUAR

NR. 62 AKTI

NR. ___ VENDIMI

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë prej:

KRYESUES: ERJON BANI

ANËTARE: IRENA GJOKA

ANËTARE: FLOJERA DAVIDHI

Me pjesmarrjen e sekretares gjyqësore **Enkeleda Luga**, në Tiranë, sot më datë **16.06.2022**, pasi mori në shqyrtimin në seancë gjyqësore publike, çështjen penale me Nr. 62 Akti, me palë:

KËRKUES:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga Prokuroria **Enkeleda Millonai**.

I PANDEHUR:

Judmir Shurdhi, i biri i Flamur dhe i Shpresa, datëlindja 06.08.1980, lindur dhe banues në Lushnje, me adresë: Lagja "18 Tetori", Rruga "Besim Golemi", me shtetësi shqiptare, me gjendje civile "*I martuar*", me gjendje gjyqësore "*I padënuar*", hetuar në gjendje të lirë, mbrojtur nga **Av.Emiliano Braho**, me Nr. license 4045 anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprave penale të "*Shpërdorimit të detyrës*" parashikuar nga nenin 248 i Kodit Penal dhe "*Shkelje e barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike*" kryer në bashkëpunim (*per tenderin e vitit 2019 per sherbimin e transportit te punonjesve*), parashikuar nga nenet 258 e 25 të Kodit Penal, para ndryshimeve që ka pësuar Kodi Penal me Ligjin Nr. 43/2021.

I PANDEHUR:

Krenar Gozhina, i biri i Islam dhe i Nexhmije, datëlindja 11.02.1988, lindur në Berat dhe banues në Lagja “28 Nëntori”, Dimali, me gjendje civile “*Beqar*”, me gjendje gjyqesore “*I padënuar*”, hetuar në gjendje të lirë, mbrojtur nga **Av.Pëparim Kulluari**, me Nr. License 8595 anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprave penale të “*Shkeljes së barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike*” në bashkëpunim (për tenderin e vitit 2018 dhe 2019 për shërbimin e transportit të punonjësve), dy herë, parashikuar nga nenet 258 e 25 të Kodit Penal, para ndryshimeve që ka pësuar Kodi Penal me Ligjin Nr. 43/2021.

I PANDEHUR:

Erjon Çela, i biri i Beharit dhe i Zeles, datëlindja 31.12.1979, lindur në Lushnje dhe banues në Karbunarë e Madhe, me adresë: Lagja “Fotaq Filipi”, Godina nr. 44, me shtetësi shqiptare, me gjendje civile “*I martuar*”, me gjendje gjyqesore “*I padënuar*”, hetuar në gjendje të lirë, mbrojtur nga **Av.Klodjan Hajvazi**, me Nr. License 4220 anëtar i Dhomës së Avokatisë Lushnje.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprës penale të “*Shkeljes së barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike*” në bashkëpunim (për tenderin e vitit 2018 për shërbimin e transportit të punonjësve), parashikuar nga nenet 258 e 25 të Kodit Penal, para ndryshimeve që ka pësuar Kodi Penal me Ligjin Nr. 43/2021.

E PANDEHUR:

Miranda Idrizi, e bija e Xhevahir dhe e Hajshe, datëlindja 17.08.1983, lindur në Lushnje, banuese në Lagja Çlirimi, Bulevardi i palmave, Lushnje, me shtetësi shqiptare, me gjendje civile “*I divorcuar*”, me gjendje gjyqesore “*E padënuar*”, hetuar në gjendje të lirë, mbrojtur nga **Av.Fatmir Lushi**, me Nr. License 10495 anëtar i Dhomës së Avokatisë Elbasan.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprës penale të “*Shkeljes së barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike*” në bashkëpunim (për tenderin e vitit 2019 për shërbimin e transportit të punonjësve), parashikuar nga nenet 258 e 25 të Kodit Penal, para ndryshimeve që ka pësuar Kodi Penal me Ligjin Nr. 43/2021.

E PANDEHUR:

Xhejsika Kaja, e bija e Gëzim dhe e Vera, datëlindja 03.10.1992, lindur dhe banues në Lushnje, me adresë: Lagjia “Loni Dharmo”, Rruga “Vath Korreshi”, me shtetësi shqiptare, me gjendje civile “*E martuar*”, me gjendje gjyqesore “*E padënuar*”, hetuar në gjendje të lirë, mbrojtur nga

Av.Ervin Zoto, me Nr. License 7791 anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

AKUZUAR:

Për kryerjen e veprës penale të “*Moskallëzim i krimi*” parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

Në përfundim të gjykimit zhvilluar në prani të **prokurores Enkeleda Millonai, të pandehurve Judmir Shurdhi, Erjon Çela dhe Miranda Idrizi**, si dhe mbrojtësit e të pandehurve, konkretisht **Av.Emiljano Braho, Av.Përparim Kulluri, Av.Klodjan Hajvazi, Av.Fatmir Lushi dhe Av.Ervin Zoto**, Gjykata, pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes dhe çmoi dhe vlerësoi në tërësi provat e marra në seancë gjyqësore nënshtruar rregullave të gjykimit dhe dëgjoi në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët, në të cilën u kërkua:

Prokuroria: 1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Judmir Shurdhi**, për kryerjen e veprës penale të “*Shpërdorimit të detyrës*”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal, duke e denuar me **4 (katër) muaj burgim. 1.1.** Deklarimin fajtor të të pandehurit Judmir Shurdhi, për kryerjen e veprës penale të “*Shkelje e barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike*” kryer në bashkëpunim (per tenderin e vitit 2019 per sherbimin e transportit te punonjesve), parashikuar nga nenet 258 e 25 të K.Penal, duke e denuar me **6 (gjashtë) muaj burgim. 1.2.** Në aplikim të nenit 55 të K.Penal, dënimin e tij me **6 (gjashtë) muaj burgim. 1.3.** Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale denimin e ketij te pandehuri me **4 (katër) muaj burgim. 2.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Krenar Gozhina**, për kryerjen e veprës penale të “*Shkeljes së barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike*” në bashkëpunim (per tenderin e vitit 2018 per sherbimin e transportit te punonjesve), parashikuar nga neni 258 e 25 i K.Penal, para ndryshimeve qe ka pesuar K.Penal me ligjin nr. 43/2021, duke e denuar me **4 (katër) muaj burgim. 2.1.** Deklarimin fajtor të të pandehurit Krenar Gozhina, për kryerjen e veprës penale të “*Shkeljes së barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike*” në bashkëpunim (per tenderin e vitit 2019 per sherbimin e transportit te punonjesve), parashikuar nga neni 258 e 25 i K.Penal, para ndryshimeve qe ka pesuar K.Penal me ligjin nr. 43/2021, duke e denuar me **6 (gjashtë) muaj burgim. 2.2.** Në aplikim të nenit 55 të K.Penal, dënimin e tij me **6 (gjashtë) muaj burgim. 2.3.** Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale denimin e ketij te pandehuri me **4 (katër) muaj burgim. 3.** Deklarimin fajtor të të pandehurës **Miranda Idrizi**, për kryerjen e veprës penale të “*Shkeljes së barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike*” në bashkëpunim (per tenderin e vitit 2019 per sherbimin e transportit te punonjesve), parashikuar nga neni 258 e 25 i K.Penal, para ndryshimeve qe ka pesuar K.Penal me ligjin nr. 43/2021, duke e denuar me **4 (katër) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim. 2.4.** Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale denimin e kesaj te pandehure me **3 (tre) muaj burgim. 3.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Erion Çela**, për kryerjen e veprës penale të “*Shkeljes së barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike*” në bashkëpunim (per tenderin e vitit 2018 per sherbimin e transportit te punonjesve), parashikuar nga neni 258 e 25 i K.Penal, para ndryshimeve qe ka pesuar K.Penal me ligjin nr. 43/2021, duke e denuar me **4 (katër) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë burgim. 3.1.** Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale denimin e ketij te pandehuri me **3 (tre) muaj burgim. 3.2.** Në aplikim të nenit 59 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit te denimit me

burgim dhe venien ne prove te ketij te pandehuri per 6 (*gjashtë*) muaj. **3.3.** Te urdherohet i pandehuri te mbaje kontakte me sherbimin e proves dhe te vihet ne prove, me kusht qe gjate kohes se proves te mos kryeje veper tjeter penale. **4.** Deklarimin fajtor të të pandehurës **Xhejsika Kaja**, për kryerjen e veprës penale të “*Moskallzimit të krimi*” parashikuar nga neni 300 paragrafi i parë i K.Penal, duke e denuar me **3 (tre) muaj burgim**. **4.1.** Ne aplikim te nenit 406 te K.Pr.Penale denimin e kesaj te pandehure me **2 (dy) muaj burgim**. **4.2.** Në aplikim të nenit 63 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit te denimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që e pandehura të kryejë një punë në interes pubik, prej 60 (*gjashtëdhjetë*) orësh. **4.3.** Te urdherohet e pandehura te mbaje kontakte me sherbimin e proves dhe te vihet ne prove, me kusht qe gjate kohes se proves te mos kryeje veper tjeter penale. **5.** Ne lidhje me provat materiale te sekuestruara ne origjinal, ne baze te nenit 190 te K.Pr.Penale: Dokumentacioni ne origjinal i prokurimit “Kerkese per propozim” me objekt ‘Sherbim i transportit te punonjesve me uniforme te I EVP Lushnje’ per vitin 2019; Dokumentacioni origjinal i prokurimit “Kerkese per propozim” me objekt “Sherbim i transportit te punonjesve me uniforme te I EVP Lushnje” per vitin 2018. T’i kthehen I EVP – se Lushnje. **6.** Shpenzimet proceduriale të kryera në hetim paraprak si dhe ato të kryera gjatë gjykimit, t’i ngarkohen solidarisht të pandehurëve.

Mbrojtësi i të pandehurit Judmir Shurdhi: Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Judmir Shurdhi. Në rast se gjykata nuk arrinë në konkluzionin e pafajësisë atëherë kërkojmë në bazë të nenit 63 të Kodit Penal atë të pezullimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik.

I pandehuri Judmir Shurdhi: Dakord me avokatin.

Mbrojtësi i të pandehurit Kranar Gozhina: Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit Kranar Gozhina. Në rast se gjykata e gjen fajtor dhe e dënon të aplikohet neni 59 i Kodit Penal.

Mbrojtësi i të pandehurit Erjon Çela: Aplikimin e nenit 63 të Kodit Penal për kryerjen e një pune në interes publik.

I pandehuri Erjon Çela: Kërkoj mëshirë.

Mbrojtësi i të pandehurës Miranda Idrizi: Deklarimin e pafajshëm të të pandehurës Miranda Idrizi. Në rast se gjykata nuk arrinë në konkluzionin e pafajësisë atëherë kërkojmë në bazë të nenit 63 të Kodit Penal atë të pezullimit të vendimit me burgim dhe detyrimin për kryerjen e një pune në interes publik.

E pandehura Miranda Idrizi: Dakord me avokatin.

Mbrojtësi i të pandehurës Xhejsika Kaja: Pushimin e çështjes. Nëse nuk vendoset pushimi të aplikohet neni 63 i Kodit Penal dhe nëse nuk pranohet kjo kërkojmë të dënohet me gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 190, 379, 380, 389 dhe 390 të Kodit të Procedurës Penale dhe neneve 1/c, 25, 35, 47-50, 59, 248 dhe 258 të Ligjit Nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Judmir Flamur Shurdhi** për kryerjen e veprës penale të *“Shpërdorim i detyrës”*, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **2 (dy) vjet burgim**.
2. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Judmir Flamur Shurdhi** për kryerjen e veprës penale të *“Shkelje e barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike”*, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **1 (një) vit burgim**.
3. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri **Judmir Flamur Shurdhi** dënohet me një dënim të vetëm prej **2 (dy) vjet burgim**.
4. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Judmir Flamur Shurdhi** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **1 (një) vit e 4 (katër) muaj burgim**.
5. Vuajta e dënimit të kryhet nga i pandehuri **Judmir Flamur Shurdhi** në një burg të sigurisë së zakonshme.
6. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Judmir Flamur Shurdhi** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh**.
7. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Krenar Islam Gozhina** për kryerjen e veprës penale të *“Shkelje e barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike”*, (për tenderin e vitit 2018 për shërbimin e transportit të punonjesve) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **1 (një) vit burgim**.
8. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Krenar Islam Gozhina** për kryerjen e veprës penale të *“Shkelje e barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike”*, (për tenderin e vitit 2019 për shërbimin e transportit të punonjesve) e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **1 (një) vit burgim**.
9. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal në bashkim të dënimeve i pandehuri **Krenar Islam Gozhina** dënohet me një dënim të vetëm prej **1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim**.
10. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Krenar Islam Gozhina** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **1 (një) vit burgim**.
11. Vuajta e dënimit të kryhet nga i pandehuri **Krenar Islam Gozhina** në një burg të sigurisë së zakonshme.
12. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Krenar Islam Gozhina** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh**.

13. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Erjon Behar Çela** për kryerjen e veprës penale të *“Shkelje e barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike”*, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me **9 (nëntë) muaj burgim**.
14. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Erjon Behar Çela** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **6 (gjashtë) muaj burgim**.
15. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë e të pandehurit **Erjon Behar Çela** për një periudhë kohe prej **12 (dymbëdhjetë) muajsh**, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale. Gjatë kësaj kohe i pandehuri detyrohet të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.
16. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurit **Erjon Behar Çela** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh**.
17. Deklarimin fajtor të të pandehurës **Miranda Xhevahir Idrizi** për kryerjen e veprës penale të *“Shkelje e barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike”*, e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 258 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me **9 (nëntë) muaj burgim**.
18. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurës **Miranda Xhevahir Idrizi** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **6 (gjashtë) muaj burgim**.
19. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë e të pandehurës **Miranda Xhevahir Idrizi** për një periudhë kohe prej **12 (dymbëdhjetë) mujore**, me kusht që e pandehura të mos kryejë vepër tjetër penale. Gjatë kësaj kohe e pandehura detyrohet të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e saj nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.
20. Në zbatim të nenit 35 të Kodit Penal, të pandehurës **Miranda Xhevahir Idrizi** i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike për një kohë prej **5 (pesë) vitesh**.
21. Deklarimin fajtor të të pandehurës **Xhejsika Gëzim Kaja** për kryerjen e veprës penale të *“Moskallëzim i krimit”*, parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe dënimin e saj me **9 (nëntë) muaj burgim**.
22. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Xhejsika Gëzim Kaja** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me **6 (gjashtë) muaj burgim**.
23. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë e të pandehurës **Xhejsika Gëzim Kaja** për një periudhë kohe prej **12 (dymbëdhjetë) mujore**, me kusht që e pandehura të mos kryejë vepër tjetër penale. Gjatë kësaj kohe e pandehura detyrohet të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e saj nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi.
24. Në aplikim të nenit 190 të K.Pr.Penale provat materiale të sekuestruara; i) Dokumentacioni

në origjinal i prokurimit “Kërkesë për propozim” me objekt “Shërbim i transportit të punonjësve me uniformë të IEVP Lushnje” për vitin 2019; dhe **ii**) Dokumentacioni origjinal i prokurimit “Kërkesë për propozim” me objekt “Shërbim i transportit të punonjësve me uniformë të IEVP Lushnje” për vitin 2018, t’i kthehen IEVP – së Lushnje.

25. Shpenzimet procedurale të bëra gjatë hetimeve paraprake dhe ato gjyqësore t’i ngarkohen të pandehurve në mënyrë solidare.

26. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, brenda 15 (pesëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi

U shpall sot në Tiranë, më datë 16.06.2022

GJYQTARE

FLOJERA DAVIDHI

GJYQTARE

IRENA GJOKA

GJYQTAR

ERJON BANI

SEKRETARE

ENKELEDA LUGA